



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0394

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vjosa Gradinaj-Kryetare duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "WOOD CORPORATION" L.L.C., të parashtruar kundër Vendimit për dhënie të kontratës të Kuvendi komunal i Rahovecit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Inventar per nevojat e Komunes së Rahovecit, të cilat nuk janë të përfshira në kontratë e AQP-së" me numër të prokurimit 623-23-1684-1-2-1, me 18/07/2023, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Wood Corporation" L.L.C., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 14.06.2023 (me numër protokoll 394/23), për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Inventar per nevojat e Komunes së Rahovecit, të cilat nuk janë të përfshira në kontratë e AQP-së" me nr. të prokurimit "623-23-1684-1-2-1", iniciuar nga Kuvendi Komunal Rahovec në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK).
2. Anullohet Vendimi i AK, për aktivitetin e prokurimit të precizuar si në pikën 1 të dispozitivit të këtij vendimi, ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Në të kundërtën, për mos respektim të vendimit OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa ndaj AK, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar).
4. Shqiptohet gjoba në të holla për Autoritetin Kontraktues në lartësi të shumë 5.000,00 €, për shkak të mosrespektimit të Vendimit të OSHP (Protokoll 221/23) të datës 19.05.2023, në pajtim me nenin 131, të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.
5. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara me rastin e parashtrimit të ankesës. Sipas nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP, Ankuesi, ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

6. Inicohet procedura për revokimin e certifikatës së prokurimit kundër zyrtarit përgjegjës të prokurimit të AK, për shkak të shkeljeve të dispozitës së nenit 25, paragrafi 8, të LPP;

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 06.03.2023, Kuvendi Komunal Rahovec në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me Inventar per nevojat e Komunes së Rahovecit, të cilat nuk janë të përfshira në kontratë e AQP-së “ me nr. të prokurimit "623-23-1684-1-2-1".

Me 05.04.2023, AK ka publikuar njoftimin për dhënie ku ka rekomanduar për kontratë OE "Wood Corporationn LLC". Kundër vendimit të cituar OE"Graniti"SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kurse AK ka nxjerr vendimin me 13.04.2023 mbi refuzimin e saj.

Me 19.05.2023, OSHP ka publikuar vendimin (Protokoll 221/23) me të cilin ka aprovuar ankesat si pjesërisht të bazuara dhe ka obliguar AK që të kërkojë sqarime shtesë në lidhje me një produkt në katalogun e kompanisë së rekomanduar nr8"Karige" konform nenit 72 dhe 59 të LPP.

Me 30.05.2023 AK ka publikuar vendimin për dhënie ku ka rekomanduar kontratë OE"Graniti" SH.P.K me ç ‘rast kundër këtij Vendimi, tani Ankuesi (me shënime si më sipër), ka paraqitur Kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar me 06.06.2023.

Me 14.06.2023, I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE“Wood Corporation”L.L.C. ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 394/23.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, që në pajtim me nenin 113 të LPP-së ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Lidhur me këtë, I njëjti ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 27.06.2023, duke propozuar që: (a) Ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar; (b) Vendimi i AK për dhënie të kontratës të anulohet dhe lënda të kthehet në

rivlerësim;

Duke vepruar mbi bazën e parimeve përgjithshme të parapara me nenet 6 dhe 7 dhe parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të Ligjit të cituar dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, konstatohet se:

a) Përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër, AK ka zbatuar procedurë të hapur të tenderimit, me kriteret si në vijim: procedurë e hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës 30,000.00 €;

b) Kurse, pretendimet kryesore mbi bazën e të cilave është ushtruar ankesa, konsistojnë në atë se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7,59,69 dhe 72 të LPP dhe nuk e ka zbatuar vendimin e OSHP protokoll 211/23 të datës 19.05.2023,

Duke ju referuar veprimeve të ndërmarra si më sipër, Paneli Shqyrtues konsideron se janë plotësuar kushtet për të vendosur në mënyrë meritore mbi këtë çështje, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, duke pasur parasysh faktin se aktet dhe veprimet dhe parashitjet e palëve, provat në dispozicion dhe raporti i ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me çështjen.

Ankuesi, ka pohuar se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7,59,69 dhe 72 dhe po ashtu nuk e ka respektuar vendimin e OSHP me Nr të protokollit 221/23, duke vepruar në kundërshtim me nenin 131 të LPP i cili vendim për nga përmbajtja e tij në mënyrë decitive kishte udhëzuar AK që gjatë procedurës së rivlerësimit të kërkoj sqarime shtesë për produktin e ofruar nr.8 "karrige" konform nenit 72 dhe 59 të LPP. AK po ashtu ka rekomanduar OE për kontratë I cili sipas tij/saj në ofertën e tij posedon dy te meta administrative për të cilat i njëjti duhet të shpallej i papërgjegjshëm nga AK: a)së pari deklarata nën betim e OE të rekomanduar është e nënshkruar nga personi i cili nuk ka pozitë përkatëse sipas informatev të biznesit dhe sipas të dhënave në ARBK kurse autorizimi noterial i dhënë fare nuk e autorizon për të dorëzuar oferta dhe për të nënshkruar deklarata nën betim ngase bie ndesh me nenin 109 të Ligjit për Shoqërintë Tregtare dhe po ashtu kjo çështje është sqaruar edhe me pyetjet e shpeshta të KRPP nr.40 dhe b) Vërtetimi i ATK nuk është i destinuar për prokurim public, mungon edhe çertifikata për denime penale të stafit menaxherial të OE ashtu siq është kërkuar me DT.

Eksperti Shqyrtues në raportin tij të datës 27.06.2023 ka sqaruar se vendimi i OSHP me numër. Nr. 221/23 kishte kërkuar nga AK që lidhur me produktin/artikullin nr.8 sipas katalogut të kërkoj informacione shtesë për mbështetëset e krahëve nëse janë nga druri apo jo. Në vendim citohet shprehimisht: *“Kurse lidhur me këtë pretendim paneli shqyrtues, vlerëson se AK do duhet të kërkoj sqarime nga i rekomanduari për kontratë për dëshmitë e ofruara për këtë artikull në kuptim të nenit 72 dhe 59 të LPP”*,andaj pas analizimit të pretendimeve ankimore e gjithashtu duke u bazuar në shkresat e lëndës, dokumentacionin në platformën elektronike e-prokurim, ka sqaruar:

1)Në vendimin e OSHP-së të datë 19.05.2023 me Nr.Protokolli 221/23, “detyrohet AK të kërkoj sqarime shitesë nga OE i rekomanduar për kontratë, mirëpo përkundër vendimit të cituar si më sipër AK pas rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit, nuk kishte kërkuar informacione shitesë sipas nenit 59 dhe 72 të LPP-së (gjithnjë sipas të dhënave në platformën E-prokurim) por vepron tutje dhe me 30.05.2023 nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe përmes Letrës Standarde ka eliminuar, OE “Wood Corporation LLC” me arsyetimin se “*nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së Tenderit të Seksioni II.Fleta e të dhënave të Tenderit (FDT); **Kapaciteti teknik dhe profesional:** Kërkesa2:Prezantimi i produkteve të ofruara me katalogë broshura Dëshmia 2: Katalogu me fotografi dhe specifikacion detal për të gjitha produktet siç kërkohet në specifikimet teknike*”.Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në shkruesat dhe rrjedhen e lëndës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, po ashtu duke u bazuar edhe në kërkesën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë, konsideron se, meqenëse ky aktivitet është shqyrtuar nga OSHP, AK gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit, do të duhej të vepronte sipas udhëzimeve të OSHP, duke kërkuar informacione shitesë nga OE “Wood Corporation LLC” në lidhje me produktin/artikullin nr.8, sipas nenit 59 dhe 72 të LPP-së, si dhe vlerësimin e tenderit ta bëjë në përputhje me dispozitat e ligjit dhe legjislacionit detyrësor për prokurim publik. Gjë të cilën nuk e ka ndërmarr dhe rrjedhimisht konsideron se pretendimin e ankuesit në këtë pikë konsiderohet i bazuar nga eksperti shqyrtues.

2)Sipas pohimit të ankuesit se, Autoriteti Kontraktues e ka rekomanduar për dhënie të kontratës operatorin i cili posedon dy dokumente me të meta administrative për të cilat do duhet të shpallet i papërgjegjshëm: i). së pari deklarata nën betim e operatorit është e nënshkruar nga personi i cili nuk ka pozitë përkatëse sipas informatave të biznesit dhe sipas të dhënave në ARBK dhe se autorizimi i dhënë noterial nuk e autorizon të njëjtin të dorëzojë oferta në autoritetet kontraktuese dhe të nënshkruar deklarata nën betim dhe ii). Vërtetimi i ATK nuk është i destinuar për prokurim publik".Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit në platformën e-prokurimit përkatësisht pretendimit të Ankuesit, gjithashtu dokumentacionit tenderik të OE “Graniti ShPK”, lidhur me nënshkrimin e deklaratës nën betim nga personi i cili nuk ka pozitë përkatëse, sqaron se, në pretendimin ankimor të OE ankues, thuhet se “Nënshkrimi i deklaratës nën betim nga personi i cili nuk është drejtor bie ndesh shprehimisht me Nenin 109 të Ligjit për Shoqëritë Tregtar, E njëjta çështje është sqaruar me pyetjet e shpeshta të KRPP e ku në pyetjen nr. 40 është sqaruar se personat të cilët nuk janë pjesë e informatave të biznesit si palë e autorizuar, nuk mund të nënshkruajnë në emër të operatorit”:

Lidhur me pyetjen me nr. 40, e cila është e publikuar nga KRPP tek pyetjet e shpeshta, të shfuqizuara me datë 01.11.2022. citojmë:

“40. Si të veprohet në rastet kur dosja e tenderit, përfshirë deklaratat nën betim dhe dokumentet tjera të dosjes së tenderit nënshkruhen në emër të Operatorit Ekonomik ofertues, nga një person i pa autorizuar? Të drejtën e nënshkrimit nga një person në emër të një personi tjetër në dosjen e tenderit dhe deklaratat nën betim pa një autorizim nga personi kompetent , nuk e rregullon Ligji

për Prokurimin Publik dhe as legjislacioni dytësor i Prokurimit Publik. Megjithatë, për deri sa në Formularët standard të Dosjes së Tenderit përfshirë deklaratën nën betim dhe dokumentet tjera, kërkohen të dhënat mbi identifikimin e OE, (siç janë: Emri dhe mbiemri, pozita nënshkrimi, data, vula etj) pra kërkohet të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik (dhe jo nga një person që nuk është kompetent dhe nuk ka autorizim për ta bërë një gjë të tillë). KRPP, konsideron se, nënshkrimi " për" në emër të përfaqësuesit të OE nga një person që nuk ka autorizim për një gjë të tillë, nuk mund të jetë i pranueshëm.”. Eksperti Shqyrtues konsideron se, çështja e nënshkrimit të Deklaratës nën Betim pa një autorizim nga personi kompetent, nuk rregullohet në mënyrë eksplicite me dispozitat e ligjit dhe legjislacionit për prokurim publik. Megjithatë, duke u bazuar në pyetjen e lartëcekur (pyetja me nr. 40), nënshkrimi i Deklaratës nën Betim në rastin konkret është i pranueshëm për faktin se, në ofertën e OE “Graniti ShPK”, është i prezantuar autorizimi, ku personi kompetent autorizon personin në fjalë, që të veprojë në emër të kompanisë. Ndërsa, sa i përket çështjes se, “Vërtetimi i ATK nuk është i destinuar për prokurim publik” Neni 65 paragrafi 4.8 i këtij ligji përcakton: Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik ndër të tjera: 4.8 “aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borgj i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë”.

Eksperti Shqyrtues sqaron se, Vërtetimi Tatimor i paraqitur nga OE në fjalë është i pranueshëm, duke qenë se, një kërkesë e tillë kërkohet për të vetmin qëllim të dëshmojë se operatori ekonomik në fjalë nuk ka borxhe aktuale të pashlyera ose obligime tjera tatimore.

Ndërsa, sa i përket çështjes se “mungon certifikata për dënimet penale të stafit menaxherial të operatorit ekonomik siç është kërkuar në dosjen e tenderit” Eksperti Shqyrtues ka sqaruar se, Në dosjen e tenderit është kërkuar “Dëshmia 3 Një vërtetim nga Gjykata që vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë. Kërkesat e shënuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimit për Kontratë, OE-të së bashku me tenderin e tyre duhet të ofrojnë një **Deklaratë nën Betim** me të cilën ata deklarojnë pranueshmërinë e tyre në përputhje me nenin 65 të këtij ligji, ndërsa **dëshmitë** lidhur me kërkesat e nenit 65 të këtij ligji të specifikuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë kërkohen vetëm nga fituesi. Pra, në rastin konkret OE ka sjellë vetëm dëshminë se Operatori ekonomik nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë sipas pikes b në dosjen e tenderit. por, jo edhe dëshminë se Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me këtë pretendim i ka falur besimin e plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues. **Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e Operatorit Ekonomik Ankues janë tërësisht të bazuara.**

Eksperti shqyrtues konsideron se, duke u bazuar në të gjeturat dhe sqarimet e lartpërmendura, po ashtu marrë parasysh shkresat e lëndës të paraqitura në këtë raport, AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 dhe 72 të LPP-së, dhe me vendimin e OSHP-së me nr. 221/23 të datë 19.05.2023, duke mos kërkuar sqarime shtesë sipas nenit 59 dhe 72 të LPP-së. Andaj, duke u bazuar në të gjeturat dhe sqarimet e lartcekura, i propozon Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Rahovec, të Anuloi Njoftimin mbi Vendimin e AK-së për këtë aktivitet të prokurimit dhe lënda të kthehet në Ri-Vlerësim, të veproj sipas vendimit të OSHP-së, që gjatë procedurës së rivlerësimit, të kërkoj sqarime shtesë nga OE “Wood Corporation LLC”, që Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi Tenderëve të bëhet në pajtim me dispozitat e ligjit dhe legjislacionit detyësor për Prokurim Publik.

-Konstatimet e Panelit Shqyrtues-

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se AK ka shkullur dispozitat e cituara si më sipër, të precizuara dhe të argumentuara ato në ankesë dhe në raportin e ekspertit shqyrtues. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesional dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkellura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP. Raporti i ekspertit shqyrtues nuk prodhon efekte detyruese për asnjërën nga palët dhe as për panelin shqyrtues, prandaj i njëjti (natyrisht dhe vlerat provuese të tij) gjithnjë analizohen në raport me të gjitha shkresat e një lënde, me rrjedhën e procesit të prokurimit, veprimet e palëve, qëllimin dhe natyrën e një aktivitetit të prokurimit, i cili në parim synon përmbushjen e nevojave publike, me përdorimin e fondeve publike, të cilat i janë besuar secilit AK, në cilin do nivel.

Paneli shqyrtues vlerëson se AK nuk ka vepruar në proporcion të drejtë me dispozitat e nenit 72 të LPP Prandaj pretendimet ankimore dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues, sipas këtij Paneli, gjejnë mbështetje në legjislacionin primar dhe sekondar për prokurimin publik, andaj pohimet ankimore konsiderohen tërësisht të bazuara pa nevojë që të njejtat të përsëriten sërish. Kurse sa i përket pohimi se Vërtetimi Tatimor i paraqitur nga OE se ka destinim tjetër jo për aktivitet të prokurimit kjo çështje mund të adresohet aspektit procedural jo-relevant por asesi atij material ngase si i tillë kërkohet për të vetmin qëllim të dëshmoj se operatori ekonomik në fjalë nuk ka borxhe aktuale të pashlyera ose obligime tjera tatimore. AK po ashtu nuk ka zbatuar drejt dispozitat e nenin 27, 59 dhe 60 të LPP-së, duke e bere ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave në kundërshtim me dispozitën e lartcekur për aktivitetin e prokurimit në fjalë si dhe dispozitën e nenit 7 të LPP-së.

Paneli po ashtu mori vendim:

- Që të shqiptohet gjoba në të holla për Autoritetin Kontraktues në lartësi të shumë 5.000,00 €, për shkak të mosrespektimit të Vendimit të OSHP të datës 19.05.2023, në pajtim me nenin 131, të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës;

-Të Inicohet procedura për revokimin e certifikatës së prokurimit kundër zyrtarit përgjegjës të prokurimit të AK, për shkak të shkeljeve të dispozitës së nenit 25, paragrafi 8, të LPP;

Me Vendimin e datës 19.05.2023, OSHP ka kërkuar që AK ta rivlerësoj aktivitetin e prokurimit në kuptim të rrethanave të shpjeguara në këtë vendim (pa nevojë të përsëriten). Në këtë rast, është jokontetuese se AK nuk ka vepruar në harmoni me Vendimin e cituar, i cili në kuptim të legjislacionit nënkupton aktin administrativ të një organi kompetent, me efekte detyrues për të gjitha palët meqë i njëjti buron nga normat kogente të LPP dhe kompetencat e OSHP, nga cilësia e tij si organ i administratës shtetërore në shkallë të dytë. Paneli konsideron (pa ndonjë paragjykim) se, përfillja e Vendimit të cituar do evitonte në kohë efektive çdo dilemë, në relacion me kriteret e paraparë.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

- Përfundim –

Duke u bazuar në kompetencat e OSHP të rregulluara sipas nenit 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër. Prandaj nisur nga të lartcekurat Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur.

Paneli Shqyrtues i OSHP, kërkon nga AK që në procesin e rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit të evitohen shlejet e cituara si më sipër të vlerësohen sërish ofertat e operatorëve ekonomik në harmoni me nenin 1,7,27, 59, 69 dhe 72 të LPP, të sigurojnë që fondet publike do të përdorën në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në paragrafët përkatës të nenit 1 të LPP. .

Meqë Ankesa e OE “Wood Corporation” L.L.C është e bazuar të njetit i lejohet kthimi i tarifës konforme dispozitave ligjore dhe Rregullores së punës së OSHP Nr 83/20 datë 03.03.2020 lidhur me nenin 118 të LPP. Prandaj bazuar në të lartëcekurat dhe konform nenit 117 të LPP, Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - WOOD CORPORATION L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: